



**Internews Kosova**

Raport nga monitorimi i pjesës  
së dytë të Testit Kombëtar të  
Maturës 2014



 **Internews Kosova**

# Raport nga monitorimi i pjesës së dytë të Testit Kombëtar të Maturës 2014

---

# Table of contents

---

## 01

Përbledhje

## 08

(Mos) Udhëzimi nga ministria e arsimit

---

## 02

KALLXO.COM

## 10

Përdorimi i mjetave elektronike

---

## 03

Mungesa e paarsyetuar e administratorëve

## 11

Disiplina e administratorëve dhe komisionarëve gjatë testimit

---

## 04

Vonesat

## 12

Disiplina e nxënësve gjatë testimit

---

## 05

Prezenca e personave të paautorizuar në qendrat e testimit

## 13

Tollovia gjatë paketimit të testeve

---

## 06

Identifikimi i Maturantëve

## 14

Rekomandime

---

## 07

Administrimi nga ana kompanive të sigurimit fizik

## 18

Publikimet

# ekipa

Kryeredaktor dhe Producant Ekzekutiv:  
Faik Ispahi, Drejtor i Internews Kosova

Autorë:  
Muhamet Hajrullahu dhe  
Kreshnik Gashi

Redaktor i rrjeteve sociale:  
Valon Canhasi

Mbikqyrës ligjor:  
Kreshnik Gashi dhe Flutura Kusari

Mbikqyrja teknike:  
Arian Hyseni

Redaktor desku:  
Përparim Isufi dhe Anton Nrecaj

Udhëheqës i deskut planifikues:  
Muhamet Hajrullahu

Menaxhere e projekteve:  
Albulena Sadiku

Lektura:  
Bekim Muhamheri

## MONITORUESIT E TESTIT TË MATURËS

### 1. Obiliq:

Labinot Leposhtica e Granit Mavriqi - Shkolla e Mesme e Ulët 'Ibrahim Rugova', Shkolla e Mesme Teknike Profesionale 'Hasan Tahsin'

### 2. Suharekë:

Qazim Hasanaj e Rahman Ramaj - Gjimnazi 'Jeta e Re', Shkolla e Mesme Teknike 'Skender Luarasi'

### 3. Kaçanik:

Petrif Çollaku e Fitore Aliu - Gjimnazi 'Skënderbeu', Shkolla Filliore 'Emin Duraku'

### 4. Ferizaj:

Njomza Salihu e Florina Ujupi - Shkolla Filliore 'Gjon Serreçi', Gjimnazi 'Shaban Hashani'

### 5. Skenderaj:

Meritë Krasniqi e Behar Mustafa - Shkolla Filliore 'Shaban Jashari', Shkolla Filliore 'Hamëz Jashari', Shkolla Teknike 'Anton Çeta'; Shkolla e Kompetencës

### 6. Lipjan:

Mërgime Vrajolli e Skender Govori - Shkolla Filliore 'Vëllezërit Frashëri', Shkolla e Mesme 'Adem Gllavica'

### 7. Mitrovicë:

Eronida Mataj e Astrict Perani - Universiteti Publik i Mitrovicës 'Isa Boletini';

### 8. Prishtinë:

Vullnet Krasniqi e Adelina Berisha - Gjimnazi 'Sami Frashëri', Shkolla e Mesme 'Eqrem Qabej', Shkolla e Mesme 'Gjin Gazulli'

### 9. Prishtinë:

Kaltrina Rexhepi e Paulina Nushi - Shkolla Filliore 'Xhemajl Mustafa', Shkolla Filliore 'Dardania'

### 10. Malishevë:

Valdet Salihu e Naim Haxhosaj - Shkolla 'Hasan Berisha'

### 11. Istog:

Lekë Muçaj e Hysen Gara - Shkolla e Mesme 'Bajram Curri'

### 12. Deçan :

Armend Zenelaj e Durim Shala - Gjimnazi 'Vëllezërit Frashëri', Shkolla e Mesme Teknike 'Tafil Kasumaj'

### 13. Gjakovë:

Yllka Hoxha e Stiven Kolaj - Shkolla Filliore 'Emin Duraku', Shkolla e Mesme Ekonomike 'Kadri Kusaril'

### 14. Prizren:

Petrif Kryeziu - Shkolla Filliore, 'Avdyl Frashëri'

### 15. Pejë:

Mehdi Mulaj e Visar Kryeziu - Palestra Sportive 'Karagaç', Shkolla Filliore 'Dardania'

### 16. Podujevë:

Arben Sylejmani e Denis Sllavinja - Shkolla e Mesme Ekonomike 'Isa Boletini', Shkolla e Mesme Teknike 'Fan Noli'

17. Kamenicë:

Nektar Zogjani e Lum Ademi  
– Shkolla e Mesme ‘Fan  
Noli’;Gjimnazi ‘Ismail Qemajli’

18. Fushë Kosovë:

Qëndresa Mustafa e Laura  
Lumezi – Shkolla Fillore ‘Mihail  
Grameno’

19. Gjilan:

Gresa Musliu e Ardian Lulaj-  
Shkolla e Mesme ‘Zenel Hajdini’

20. Vushtrri:

Liridona Hyseni e Ardian Gashi-  
Salla e Sporteve ‘Jeton Tërstena’

21. Viti:

Kaltrina Hoxha e Naim Krasniqi –  
Gjimnazi ‘Kuvendi i Lezhës’

Stafi teknik:

Dardan Sinani  
Eset Dërguti  
Ermal Gashi

INTERNEWS KOSOVA

# Përbledhje

**Duke parë rëndësinë dhe vërejtjet që ishin bërë në vitet e kaluara si dhe në pjesën e parë të Testit të Maturës Shtetërore, Internews Kosova dhe BIRN-i u angazhuan që të bëjnë monitorimin e këtij procesi për pjesën e dytë të Testit Kombëtar të Maturës për vitin 2014.**

Me datën 27 qershor 2014 është nënshkruar një Memorandum i Bashkëpunimit mes MASHT-it dhe [KALLXO.com](#) për monitorimin e procesit të Testit të Maturës Shtetërore. Në bazë të këtij Memorandumi për Bashkëpunit, KALLXO.com ka monitoruar 36 qendra të testimit në 21 komuna.

Komunat e monitoruara janë: Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë, Podujevë, Kaçanik, Suharekë, Ferizaj, Skenderaj, Lipjan, Mitrovicë, Gjilan, Malishevë, Istog, Deçan, Gjakovë, Prizren, Podujevë, Pejë, Kamenicë, Vushtrri e Klinë.

Si rezultat i monitorimit, janë mbledhur më shumë se 50 raporte nga terreni, prej të cilave janë publikuar 19 artikuj të ndryshëm me tema të veçanta. Artikulli kryesor është përditësuar 28 herë gjatë ditës së testimit, me së paku 20 video-xhirime dhe me dhjetëra fotografi të cilat kanë prezantuar gjendjen të cilën e kanë hasur monitoruesit e KALLXO.com.

Raportet e KALLXO.com dëshmojnë se në shkollat e monitoruara ka pasur mangësi të dukshme në përgatitjen dhe mbarëvajtjen e procesit të testimit. Edhe përkundër masave të ndërmarra, si për shembull angazhimit të kompanive të sigurimeve fizike për administrim të testit pas dështimit të stafit të mësimdhënësve të shkollave të mesme që të administrojnë pjesën e parë të Testit Kombëtar, qendrat e monitoruara nuk kanë dhënë përshtypje të një ambienti akademik për mbajtje të papenguar të Testit Kombëtar të Maturës.

Ky raport përmban detaje të të gjeturave, të cilat mund të konsiderohen si të gjatura të përbashkëta që do të karakterizonin të gjitha qendrat e monitoruara.



**Platforma online [www.KALLXO.com](http://www.KALLXO.com) është projekt i përbashkët i organizatave Internews Kosova, Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), OJQ-së “LENS” dhe Agjencisë Kundër Korruption, ndërsa mbështetet financiarisht nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).**

Platforma ofron mundësinë për të gjithë qytetarët e Kosovës që të raportojnë rastet e korrupsionit, krimit të organizuar, mashtimit, konfliktit të interesit si dhe të gjitha rastet e tjera të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, neglizhencës, mospunës, rrezikimit të të drejtave të qytetarëve të Kosovës, apo rrezikimit të interesave të përgjithshme.

Internews Kosova (I/KS) është organizatë joqeveritare jofitimprurëse, e themeluar në vitin 1999.

Synimi kryesor i I/KS-së është zhvillimi i demokracisë, përkrahja e shoqërisë civile dhe zhvillimi i mediave të pavarura, gazetarisë profesionale dhe raportimit hulumtues në Kosovë dhe rajon.

I/KS-ja në bashkëpunim me BIRN-in prodhon emisionet “Jeta në Kosovë” dhe “Drejtësia në Kosovë”.

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) është organizatë mediale e specializuar për gazetari hulumtuese, monitorim të shërbimeve publike dhe transmetime televizive.

Për afër dhjetë vjet BIRN-i prodhon dhe transmeton në Radio Televizionin e Kosovës emisionet “Jeta në Kosovë” dhe “Drejtësia në Kosovë”, publikon Gazetën “Jeta në Kosovë” online dhe boton gazetën e vetme në gjuhën angleze në Kosovë “Prishtina Insight”. Gjithashtu, për më shumë se katër vjet BIRN-i monitoron shërbimet publike.

INTERNEWS KOSOVA

# Mungesa e paarsyetuar e administratorëve

Monitoruesit e KALLXO.com kanë raportuar se në disa prej qendrave personat përgjegjës për t'u kujdesur për mbarëvajtjen e testimit nuk kanë shkuan në punë ditën kur është mbajtur testimi.

Shembull për këtë është qendra e testimit në Gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë ku kanë munguar dy zyrtarë të paracaktuar për monitorimin e testimit.

Mensur Neziri, zyrtar i MASHIT-it në këtë qendër i ka thënë KALLXO.com se vetëm njëri nga tre zyrtarët e UP-së të cilët ishin të paracaktuar për ta monitoruar këtë qendër është paraqitur aty. Kjo mosparaqitje e zyrtarëve ka shkaktuar probleme në këtë qendër përsa i përket organizimit dhe kontrollit të testimit.


Po ashtu në shkollën "Kadri Kusari" në Gjakovë, ka munguar njëri nga zyrtarët e MASHIT-it që ishte caktuar për të monitoruar në këtë qendër. Zyrtarët e kësaj qendre nuk i kanë dhënë shpjegime monitoruesit të KALLXO.com se kush është ky zyrtar dhe cila është arsyeja e mungesës së tij.

Gjatë ditës së testimit, monitoruesit e KALLXO.com kanë marrë ankesë nga Artan Alidema, i dërguari MASHIT-it në Shkollën e Mesme "Zenel Hajdini" në Gjilan. Alidema është ankuar se e kanë të pamundur që t'i kontrollojnë 200 nxënës me vetëm 5 roje të sigurimit.

Alidema është ankuar edhe për problemet që i kanë pasur gjatë shoqërimit të nxënësve në toalet, pasi që nuk ka pasur roje sigurimi femër e cila do i shoqëronte vajzat në toalet.

Në mungesë të kësaj, shoqërimi i vajzave në tualet është bërë nga ana e dy zyrtareve të MASHIT-it të cilat për detyrë e kanë pasur kontrollin e testimit, e jo shoqërimin e nxënësve në toalet.

**Shoqërimi i vajzave  
në tualet është  
bërë nga ana e  
dy zyrtareve të  
MASHIT-it të cilat për  
detyrë e kanë pasur  
kontrollin e testimit,  
e jo shoqërimin e  
nxënësve në toalet.**



INTERNEWS KOSOVA

# Vonesat

Problem tjetër i identifikuar nga monitoruesit e KALLXO.com ka qenë vonesa e arritjes së stafit të angazhuar nga MASHT-i dhe materialeve në qendrat ku do mbahej testimi.

Monitoruesit kanë raportuar se në dy qendra, njëra në Prizren dhe tjetra në Gjakovë, ka pasur vonesa në nisjen e testimit për shkak të mosarritjes me kohë të testeve.

Monitoruesi i KALLXO.com ka raportuar se testimi në shkollën "Kadri Kusari" në Gjakovë ka nisur me vonesë për shkak se testet kanë arritur në këtë shkollë në orën 09:40 minuta, edhe pse ishin dashur të vinin jo më vonë se në orën 09:00.

Vonesë e madhe është shkaktuar edhe në qendrën e testimit në shkollën "Avdyl Frashëri" në Prizren. Në këtë shkollë po mbahej testimi edhe për nxënësit e Shkollës së Mesme të Muzikës "Lorenc Antoni".

**Testet për këta nxënës kanë arritur me vonesë prej 1 orë e 20 minutash për shkak se MASHT-i i ka ngatërruar testet e kësaj shkolle me testet e shkollës profesionale të artit.**

Ky gabim i MASHT-it ka krijuar një klimë të pakëndshme në shkollë për shkak se nxënësit është dashur të presin më shumë se 1 orë e 20 minuta, e po ashtu kanë penguar nxënësit e shkollave të tjera të cilët ishin duke iu nënshtruar testit në po atë qendrë.



INTERNEWS KOSOVA

# Prezenca e personave të paautorizuar në qendrat e testimit

Në shumë prej qendrave të testimeve, monitoruesit e KALLXO.com kanë vërejtur prezencë të zyrtarëve të drejtorive komunale të arsimit, kryesishk drejtorëve të arsimit, **të cilët kanë të drejtë të kryejnë monitorimin e testimit, por jo edhe të ndërhyjnë në të.**

Siç raportojnë monitoruesit, vizitat kryesishk kanë qenë nga zyrtarë të drejtorive komunale të arsimit dhe vizitat e tyre zakonisht janë shoqëruar me prishje të qetësisë dhe dekoncentrim të nxënësve gjatë testimit.

Për shkak të prishjes së qetësisë, në shkollën e mesme "Bajram Curri" në Istog, zyrtarët e MASHT-it e kanë larguar nga qendra e testimit drejtorin e Drejtorisë së Arsimit të kësaj komune, Agim Haxhiu.

Largimi i tij nga qendra ka ardhur pasi Haxhiu ka folur me zë të lartë në qendrën e testimit, duke u ankuar se rregullat e MASHT-it i kanë stresuar nxënësit. Pasi është vlerësuar se prezenca e drejtorit të arsimit po e prish qetësinë, zyrtarët e MASHT-it, Faton Ismaili dhe Gëzim Qerimi, i kanë kërkuar drejtorit të largohet nga qendra e testimit.

Pak kohë më pas nga kjo shkollë është larguar edhe Bedri Hajzeraj, një zyrtar tjetër i kësaj drejtorie, për shkak se ka prishur qetësinë dhe mbarëvajtjen e testimit.

INTERNEWS KOSOVA

# Identifikimi i Maturantëve



Në disa qendra të testimit, si në qendrën e testimit në “Karagaç” të Pejës dhe në shkollën “Kadri Kusari”, nxënësit janë lejuar të futen në qendër të testimit pa kontroll të duhur të identitetit të tyre.

**Identifikimi i maturantëve është bërë vetëm më vonë, pas që kanë hyrë në qendër të testimit, më saktësisht pas shpërndarjes së testeve, me ç'rast zyrtarët kanë hasur në disa maturantë pa dokumente të duhura të identifikimit.**

Kjo ka përfunduar ashtu që disa nga këta maturantë janë përashtuar përkohësisht nga testi, derisa familjarët e tyre ua kanë sjellë dokumentet e nevojshme. Përashtimi i maturantëve nga qendra për shkak të mungesës së dokumenteve identifikuase, e pastaj lejimi i tyre që të

kthehen, ka shkaktuar huti dhe e ka penguar mbarëvajtjen e procesit të testit të maturës.

Në qendrën e testimit “Karagaç” në Pejë, nxënësi A.M. është përashtuar nga testimi për shkak se nuk ka pasur letërnjoftim. Letërnjoftimet janë kontrolluar pas nisjes së testimit edhe në shkollën “Vëllezërit Frashëri” në Deçan.

Në shkollën “Kadri Kusari” një nxënëse është lejuar të vazhdojë testimin për 20 minuta pa pasur dokument identifikimi. E njëjtë nxënëse, pas një kohe është nxjerrë jashtë nga testimi që me vonë t'i lejohet kthimi në testim.

Praktika nuk ka qenë e njëjtë në shkollën tjeter të monitoruar nga KALLXO.com, në qendrën e testimit në shkollën “Xhemail Mustafa” në Prishtinë ku letërnjoftimet janë kontrolluar para nisjes së testimit. Në këtë qendër të testimit së paku tre nxënës nuk janë lejuar t'i nënshtronen testimit për shkak se nuk kanë pasur letërnjoftim.

INTERNEWS KOSOVA

# Administrimi nga ana e kompanive të sigurimit fizik

MAShT-i në fazën e dytë të testimit mori vendim që për administrimin e testimit të angazhoheshin roje të kompanive private të sigurimit fizik.

Ky vendim është marrë nga MAShT-i për shkak se raportet nga pjesa e parë e testit të maturës kanë treguar se mësimdhënësit e shkollave të mesme të angazhuan për të administruar testin e maturës ose nuk e kanë pasur autoritetin e duhur, ose nuk kanë treguar vullnet që të sigurojnë një ambient të duhur dhe të dinjitetshëm për mbarëvajtje të testit.

Një vendim i tillë i MAShT-it, për të angazhuar roje sigurie nga kompani private, është kritikuar në masë të madhe në publik.

Për më shumë, shpesh ky hap është cilësuar edhe si ofendim ndaj maturantëve dhe mësimdhënësve të shkollave të mesme.

Arsyetimet për një hap të tillë supozojmë se duhet të trajtohen në një raport të veçantë, së bashku me analizën e arsyeve pse mësimdhënësit dështojnë të krijojnë ambient të duhur për mbarëvajtje të testit.

Sidoqoftë, monitoruesit e KALLXO.com kanë arritur në përfundimin se në disa qendra të testimit, as administratorët e angazhuan nga radhët e kompanive të sigurimit fizik nuk janë kujdesur që ta kryejnë profesionalisht detyrën e tyre. Në shkollën e mesme "Tafl Kasumaj" në Deçan, monitoruesit e KALLXO.com kanë filmuar nxënës të cilët ishin grupuar dhe po kopjonin në sy të zyrtarit të sigurimit.

Në shkollën "Skënderbeu" në Kaçanik, monitoruesit tanë kanë filmuar kopjime në sy të administratorëve nga radhët e kompanive të sigurimit fizik. Në sy të zyrtarëve të sigurimit është parë se është toleruar edhe përdorimi i telefonit mobil për të kopjuar.

Në qendrën e testimit në "Karagaç" të Pejës monitoruesi ynë ka filmuar një nxënës duke përdorur telefonin shumë afër zyrtarit të sigurimit fizik.

**'KARAGAÇ'  
PEJË**

Në këtë qendër të testimit monitoruesi ynë ka filmuar një nxënës duke përdorur telefonin shumë afër zyrtarit të sigurimit fizik.

INTERNEWS KOSOVA

# (Mos) Udhëzimi nga ministria e arsimit

**Udhëzimi administrativ i quajtur “Masat disiplinore ndaj maturantëve dhe personelit përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit të maturës” është udhëzim që MASHT e ka përpiluar disa javë para mbajtjes së testit të maturës.**

Kjo urdhëresë administrative i parashtron sankcionet për thyerjen e disiplinës gjatë testit. Por, kësaj urdhërese nuk i ka paraprirë një udhëzues detajuar i cili do të ishte i çasshëm për të gjithë të interesuarit që të kuptojnë saktësisht rregullat se çka lejohet e çka nuk lejohet gjatë testit të maturës.

Në anën tjetër, duke pasur parasysh faktin që i tërë sistemi akademik i është nënshtruar një inflacioni moral, duke filluar nga raportet e keqpërdorimeve të vazhdueshme e të pasanksionuara gjatë testeve kombëtare të viteve të kaluara e deri te skandalet akademike në vet kreun e sistemit arsimor në Kosovë, MASHT është dashur të sigurohet që të ndërmarrë të gjitha masat për të sqaruar sa më mirë kodin e duhur të sjelljes së pranueshme gjatë Testit Kombëtar e jo vetëm të publikojë listën e sanksioneve.

Më saktësisht, KALLXO.com konsideron se MASHT është dashur që për pos nxjerrjes së urdhëresës administrative, të ndërmerrë edhe hapa të mëtejmë si:

**a** Të sigurojë qasje të papenguar të publikut të gjerë, të zyrtarëve të involvuar në procesin e testimit, të prindërvë, të maturantëve dhe palëve tjera me interes në këtë dokument përmes publikimit në internet;

**b** Përpos nxjerrjes së listës së sanksioneve, të nxjerrë edhe listën e instrukcioneve të sakta se si duhet të sillen nxënësit gjatë testimit;

**c** Të përpilojë protokol të qartë se cilat janë rregullat e sakta që duhet t'i zbatojë i tërë stafi zyrtar i MASHT, zyrtarët komunal, administratorët e testit dhe i tërë personeli tjetër i përfshirë në organizim dhe mbarëvajtje të testit.

Para se t'i listojmë problemet tjera të hasura në montiorim, ky është një propozim se si do të mund të duken instrukcionet të cilat MASHT do të duhej t'i bëjë publike para secilit test. Instrukcionet ne faqen e ardheshme janë marrë nga rregullat e testimit në Universitetin e Oxfordit që janë rregulla standarde që përdoren edhe në shkolla të mesme të Britanisë së Madhe.

<sup>1</sup> Kësaj atmosferë i ndihmon edhe një atmosferë akademike që nga lidershipi i Univerzitetit të Prishtinës e deri në nivelet më të ulëta të shkollimit ku kopjimi dhe gjetja e rrugës së shkrutë deri te nota dhe diplomimi është ves, nëse jo i inkurjuar, ves totalisht i tolerueshëm në sistemin shkollor në Kosovë

&gt;&gt;

## Rregullat e nënshtimit të testit në Univerzitetin e Oxford<sup>1</sup>

### DUHET

Të jeni në ambientet  
ku do të zhvillohet  
testi 20 minuta para  
kohës

Të lexoni me kujdes  
udhëzimet në faqen e  
parë të testit tuaj

Të shkruani me  
stilolaps të kaltër ose  
të zi

Të siguroheni që  
pjesët ku keni  
ushtruar t'i mbuloni  
me X

Të shënoni numrin e  
pyetjeve të përgjigjura  
në faqen e parë të  
testit

T'i mbushni të dhënat  
tuaja në fillim të  
testit: numrin e  
kandidatit, datën dhe  
testin

### NUK DUHET

Të jeni në ambientet  
ku do të zhvillohet  
testi saktë në kohën  
kur është caktuar të  
mbahet

Të dilni nga testi në 30  
minutat e para ose të  
fundit të procesit

Të shkruani me laps

Nëse shënimet tuaja  
ku keni ushtruar  
nuk i mbuloni me X,  
vlerësuesi mund ta  
konsiderojë atë si pjesë  
të përgjigjes

Të shënoni në kolonat  
e dedikuara për  
vlerësuesin në faqen e  
parë të testit

Të shkruani emrin  
e plotë, numrin  
identifikues të  
universitetit në faqen e  
parë të testit

## Kodi i Sjelljes në Test në Univerzitetin e Oxford<sup>2</sup>

### DUHET

Të ngritni dorën nëse  
keni pyetje

Të ngritni dorën nëse  
dyshoni se ka gabim  
në fletën tuaj të testit

Të ngritni dorën nëse  
keni nevojë ta lëshoni  
ambientin e testit, për  
shembull në rast të  
ndonjë sëmundje

Të dilni e hyni në test pa  
lejen e administratorit

### NUK DUHET

Përveç administratorit,  
të komunikoni me dikë  
tjetër gjatë kohës së  
testit

Të pyetni nëse nuk  
kuptoni ndonjë fjalë  
apo term në testin tuaj;  
as vlerësuesit dhe as  
administratorit nuk i  
lejohet t'ju përgjigjen

<sup>1</sup> <http://www.ox.ac.uk/students/academic/exams/guidance>

<sup>2</sup> Për rregulla e isstrukcione më të detajuara shih <http://www.admin.ox.ac.uk/examregs/contents.shtml>

INTERNEWS KOSOVA

# Përdorimi i mjetave elektronike

## a. Telefonët

Urdhëresa administrative me nr ... paralajmëron se do të sanksionojoë ashpër përdorimin e telefonave mobilë dhe pajisjeve elektronike të cilat mund të shfrytëzohen për keqpërdorime gjatë procesit të testimit.

Pasi urdhëresa nuk ka ofruar detaje konkrete dhe nuk e ka qartësuar se a lejohen të merren me veti telefonat në testim apo jo, reagimi i administratorëve në menaxhim të këtyre rasteve ka qenë i larmishëm.

Monitoruesit e KALLXO.com kanë ardhur në përfundim se MASHT-i nuk ka siguruar sqarime të sakta dhe të uniformuara në lidhje me atë se si duhet të sillen zyrtarët e qendrave të testimit në rast se hasin në pajisje elektronike te maturantët të cilët i nënshtronen testim.

Në qendra të caktuara si shkolla "Xhemajl Mustafa" në Prishtinë, administratorët kanë vendosur që t'i grumbullojnë telefonat në tavolinën e tyre dhe t'i mbështjellin me letër, ndërsa në disa qendra të tjera administratorët nuk kanë kërkuar që maturantët t'i largojnë telefonat, por vetëm u kanë kërkuar që t'i shkyçin nga rrjeti.

## b. Rrjetet sociale

Përpos dallimeve në mënyrën se si është kontrolluar çështja e telefonave dhe pajisjeve elektronike, KALLXO.com ka monitoruar edhe rrjetet sociale, me ç'rast është hasur në raste konkrete të përdorimit të telefonave celularë gjatë procesit të testimit dhe tentimeve për keqpërdorim dhe mashtrim gjatë testit.

Dy nxënës nga Podujeva kishin arritur që nga brenda qendrës së testimit, gjatë procesit të testimit, të postonin fotografi të testit. Pas raportimit të KALLXO.com, MASHT-i ka ndërrhyrë në këtë shkollë duke i identifikuar dhe sjellë para përgjegjësisë nxënësit që e kanë bërë këtë shkelje.

Po ashtu, gjatë monitorimit të qendrës testuese në "Karagaç" të Pejës, monitoruesi i KALLXO.com ka sjellë filmime ku shihet qartë përdorimi i telefonit nga njëri prej të testuarve.

**Urdhëresa nuk ka ofruar detaje konkrete dhe nuk e ka qartësuar se a lejohen të merren me veti telefonat në testim apo jo.**

INTERNEWS KOSOVA

# Disiplina e administratorëve dhe komisionarëve gjatë testimit



Gjatë monitorimit të testit, monitoruesit e KALLXO.com kanë raportuar për prishje të qetësisë edhe nga ana e atyre që janë të thirrur për ta ruajtur atë.

**Në shumicën e raporteve, monitoruesit kanë konstatuar biseda të panevojshme në mes të nxënësve dhe monitoruesve, të cilat kanë ngjallur dyshime se nxënësve po u ndihmohet në plotësimin e testeve.**

Kur personat përgjegjës janë pyetur pse po ndodh kjo, ata janë arsyetuar se komunikimet nuk kanë pasur qëllim që

nxënësve t'u tregohen përgjigjet, por ka pasur kërkesa për sqarime dhe kërkesa për t'u lejuar shkuarja në toalet.

Komunikime të tillë, në një rast kanë eskaluar në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" në Deçan. Një nxënëse e këtij gjimnazi është përjashtuar nga procesi i testimit për shkak se është ankuar në komisionaren Ardita Berisha e cila me zë të lartë po mundohej të kërcënonte nxënësit për të mbajtur qetësi dhe për të mos kopjuar.

Sipas raportit të monitoruesit të KALLXO.com, pas kësaj proteste nxënësja e cila protestoi është nxjerrë jashtë nga testimi, ndërsa nxënësja e cila kishte bërë zhurmë kishte vazhduar testimin.



INTERNEWS KOSOVA

# Disiplina e nxënësve gjatë testimit

Problem madhor i identifikuar gjatë monitorimit të testit nga monitoruesit e KALLXO.com është tolerimi i bisedave në mes nxënësve.

Filmimet e xhiruara dhe raportet e monitoruesve të KALLXO.com tregojnë se MASHT-i përsëri ka dështuar që të krijojë kushte akademike të cilat do të siguronin atmosferë të duhur për mbarëvajtje të procesit të testimit.

Mungesa më e madhe qëndron në kulturën e zyrtarëve të MASHT-it në tolerim të sjelljes së padisiplinuar gjatë procesit të testimit. Kryesuesit e Qendrave të Testimit përsëri kanë dështuar që të imponojnë autoritet akademik dhe nuk kanë arritur që t'i disiplinojnë maturantët e prirur për sjellje të pahijshme, duke ua bërë të mundur që tu pengojnë edhe nxënësve tjerë të cilët janë sjellë sipas rregullave.

**Monitoruesit e KALLXO.com raportojnë se grupe të caktuara nxënësish kanë pasur plane konkrete se si të komunikojnë në mes veti duke përdorur “gjuhën e shenjave”.**

Për shkak se nxënësit janë ulur nëpër banka si kanë dashur vetë, kjo u ka mundësuar krijimin e grupeve të parapërgatitura për komunikim dhe shkëmbim informatash.

INTERNEWS KOSOVA

# Tollovia gjatë paketimit të testeve



Monitoruesit e KALLXO.com kanë identifikuar probleme edhe gjatë grumbullimit dhe dorëzimit të testeve të plotësuara në fund të procesit të testimit.

Fleta e testit e plotësuar sipas rregullave është dashur që të futet në një zarf dhe të dorëzohet, por në mungesë të sqarimeve të duhura, ky proces nuk ka shkuar si duhet dhe ka krijuar tollovi para tavolinës së zyrtarit i cili i ka grumbulluar dhe i ka paketuari testet e plotësuar.

Kjo kohë është shfrytëzuar nga nxënësit për të komunikuar në mes veti e po ashtu i ka penguar në testim nxënësit e tjerë të cilët ende nuk e kishin përfunduar testimin.

**Po ashtu, monitoruesit e KALLXO.com kanë identifikuar se zyrtarët e MASHT-it nuk e kanë pasur të qartë dhe nuk kanë ditur ku t'i ruajnë testet e paketuara deri në kohën kur ka arritur transporti.**

---

INTERNEWS KOSOVA

# Rekomandime

Në bazë të monitorimit të **KALLXO.com**, Internews Kosova dhe BIRN-i i rekmandojnë Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji që në të ardhmen me rastin e organizimit të Testit të Maturës Shtetërore të merren parasysh këto çështje:

**1**

Testet me shkrim të inkurajohen sa më shumë si formë e vlerësimit të dijes gjatë tërë viti shkollor, duke ndërtuar kulturën e testimit profesional si në radhët e nxënësve ashtu edhe në radhët e mësimdhënësve, ku mësimdhënësi inkurajon atmosferë profesionale dhe akademike për testim e cila inkurajon disiplinën dhe shpërbulen mos-kopjimin. Nëse krijohet praktikë që nxënësi i shkollës së mesme gjatë viteve shkollore fiton përvojë në mbajtjen e testeve, gjasat janë të mëdha që do të ndërtohet kulturë e tillë ku nxënësit edukohen të janë aleatë në mbarëvajtjen e mirë të testeve e jo subjekte që duhet kontrolluar me roje të sigurisë gjatë testimeve;

**2**

Administrimin e procesit të testimit, në plotëni ta kryejnë mësimdhënësit e shkollave të mesme, respektivisht mësimdhënësit e shkollave fillore në rastet e testit të arritshmërisë;

**3**

Të shpërndahen me shkrim, me kohë dhe në formë të qartë protokolet dhe përgjegjësitet e zyrtarëve të përfshirë në administrim të testimit, në mënyrë që të janë të njoftuar dhe përgatitur në detaje për të gjitha situatat e mundshme që mund të paraqiten gjatë procesit të testimit, për të siguruar një reagim uniform në tërë Kosovën gjatë mbarëvajtjes së testit. Disa shembuj të instrukcioneve të tilla janë dhënë në këtë raport:

&gt;&gt;

**4**

Përgjegjësia për pjesëmarrje dhe administrim të procesit të testimit të jetë e rregulluar kontraktualisht me të gjithë mësimdhënësit. Angazhimi për administrim të testit të jetë jo në baza vullnetare, por i rregulluar si obligim kontraktual i mësimdhënësve, me të drejtë dhe përgjegjësi të plota dhe të qarta. Në rastet kur vërtetohet se mësimdhënësit kanë dështuar për çfarëdo arsyen në administrim të testeve, përgjegjësia të pasqyrojë në kontratën e punës për mësimdhënie, e jo vetëm në mëditjen e ditës së testimit;

**5**

Të bëhet identifikimi i maturantëve në hyrje të qendrës së testimit, e jo pasi maturantët të hyjnë në qendër, apo pasi të fillojë testimi. Secili maturant duhet të prezantojë letërnjoftim ose dokument valid identifikimi me fotografi, përndryshe të mos lejohet të hyjë në qendër të testimit;

**6**

Të ndalohet sjellja e çfarëdo mjeti elektronik në qendër të testimit, jo vetëm të ndalohet përdorimi i tyre, por të ndalohet tërësisht hyrja e nxënësit në testim me telefon apo mjet elektronike apo mjetet e tjera që janë të listuara si të ndaluara në instrukcione që duhet të publikohen nga MASHT;

**7**

Të ndalohet përdorimi i telefonit celular në sallat ku bëhet testimi edhe për zyrtarët e MASHT-it;

**8**

Të aplikohet pa përashtim rregulli që pasi të fillojë testimi, askush nuk lejohet të hyjë ose të dalë nga qendra e testimit pa përfunduar zyrtarisht procesi i testimit, përvèç daljes në toalet ku nxënësit do të përcillen nga mbikqyrësi i gjinisë së njejtë. Personat të cilët dalin para përfundimit zyrtar të testit për arsyen tjera, të mos kenë të drejtë të kthehen në sallën ku mbahet testimi. Maturantët me nevoja të posaçme, mund të kërkojnë paraprakisht nga MASHT-i që të krijohen kushte të posaçme për nevoja të tyre. MASHT-i duhet t'i shqyrtojë këto kërkesa dhe do të veprojë sipas ligjit;

&gt;&gt;

**9**

Të ketë orë muri në secilën sallë ku mbahet testi, në mënyrë që nxënësit të dinë për kohën e mbetur dhe ta planifikojnë më mirë;

**10**

Të lajmërohen nxënësit në përfundim të orës së parë, orës së dytë dhe për 30 minutat dhe 10 minutat e mbeturat e testit;

**11**

Të krijohet hapësirë e mbrojtur dhe sistem i mbledhjes dhe ruajtjes së gjërave personale, duke përfshirë çantat e dorës dhe telefonat në hyrje të secilës qendër të testimit;

**12**

Të rritet distanca në mes të ulëseve, në mënyrë që maturantët të mos i pengojnë njërit-tjetrit gjatë procesit të testimit;

**13**

Maturantët e arsimimit profesional të mos i nënshtrohen testimit në të njëjtën sallë me maturantët e rregullt;

**14**

Të sigurohet ambient i të pastër pa kundërmim të toaletit, ngase ndikon negativisht në koncentrim të maturantëve për testim;

**15**

Ventilimi kualitativ i sallës ku mbahet testimi të bëhet edhe gjatë kohës së testimit;

&gt;&gt;

**16**

Në oborrin e shkollës të mos lejohen të futen familjarë apo persona tjerë të paautorizuar, të cilët nuk kanë për t'iu nënshtuar testimit;

**17**

Persona të pa-autorizuar duhet llogaritur edhe ata persona të drejtoreve të arsimit nëpër komuna, qofshin këta edhe drejtore, të cilët nuk i ka përgjedhur MASHT si pjesë e ekipeve inspektuese për testin e maturës;

**18**

Veshja e maturantëve gjatë procesit të testimit të jetë në përputhje me rregullat e shkollës, sikur edhe gjatë procesit të zakonshëm shkollor;

**19**

Testi të mos mbahet më në hapësira të cilat nuk ofrojnë kushte të duhura akustike;

**Raportet e KALLXO.com dëshmojnë se në shkollat e monitoruara ka pasur mangësi të dukshme në përgatitjen dhe mbarëvajtjen e procesit të testimit. Edhe përkundër masave të ndërmarra, si për shembull angazhimtë kompanive të sigurimeve fizike për administrim të testit pas dështimit të stafit të mësimdhënësve të shkollave të mesme që të administrojnë pjesën e parë të Testit Kombëtar, qendrat e monitoruara nuk kanë dhënë përshtypje të një ambienti akademik për mbajtje të papenguar të Testit Kombëtar të Maturës.**

**Ky raport përmban detaje të të gjeturave, të cilat mund të konsiderohen si të gjetura të përbashkëta që do të karakterizonin të gjitha qendrat e monitoruara.**

---

INTERNEWS KOSOVA

# Publikimet në lidhje me monitorimin e Testit të Maturës 2014:

**Kapen nxënësit që shpërndanë testin në Facebook në Podujevë**

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Kapen-Nxenesit-qe-Shperndane-Testin-ne-Facebook-VIDEO-1342>

**Kopjohet në sy të sigurimit**

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Kopjohet-Ne-Sy-Te-Sigurimit-TV-1348>

**Kopjohet me telefon në Pejë**

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Kopjohet-me-Telefon-ne-Peje-1363>

**Maturantët përjashtohen nga testi në Pejë**

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Flasin-Dy-Maturantet-e-Perjashtuar-nga-Testimi-ne-Peje-1345>

**Arrestohen dy persona afër Qendrës së Testimit në Malishevë**

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Arrestohen-Dy-Persona-Afer-Qendres-se-Testimit-ne-Malisheve-TV-1344>

**MAShT-i largon nga shkolla e Istogut edhe zyrtarin e arsimit**

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/MAShT-i-Largon-nga-Shkolla-e-Istogut-Edhe-Zyrtarin-e-Arsimit-1338>

**I anulohet testi pasi zihet duke e fotografuar atë**

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/I-Anulohet-Testi-Pasi-Zihet-Duke-e-Fotografuar-Ate-1341>

**Nxënësit kopojnë me telefona në Kamenicë**

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Nxenesit-Kopojne-me-Telefona-ne-Kamenice-1340>

>>

### Përjashtohen në Gjilan, Gjakovë e Deçan

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Perjashtime-ne-Gjilan-Gjakove-e-Decan-1339>

### Vonohen testet në Prizren

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Testet-ne-Shkollen-Lorenc-Antoni-Arrijne-me-Vonese-1335>

### Vonohet Testi në Gjakovë

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Vonohen-Testet-ne-Gjakove-1332>

### Nuk i lënë në test se nuk kanë letërnjoftim në Prishtinë-

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Nuk-i-Lene-ne-Test-Se-Nuk-e-Kane-Leternjoftimin-1334>

### Mungon zyrtari i MASHIT-it në Suharekë

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Mungon-Zyrtari-i-MASHIT-it-ne-Suhareke-1333>

**Të gjitha informatat e raportimit dhe monitorimit i gjeni këtu:**

<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Perfundon-Testi-i-Matures-2014-1331>

Internews Kosova

Menza e studenteve, Kati i pare,  
10000 Prishtine, Kosovo

T + 381 38 22 44 98

Design by **red<sup>9</sup>**